



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 30.08.21 Ref: 3115/21D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), nenin 108 të Ligjit mbi procedurën administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), me datë 27.07.2021, në mbledhjen e tij të 87-të, mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (përmirësim) e vendimit Nr. 1362/19D, datë 29.07.2019 të Kolegjit Universum në pikën I të vendimit:

I. Korrigjohet (ndryshohet) pika I e vendimit të KShC-së Nr. 1362/19D, datë 29.07.2019 si në vijim:

Akreditohet Kolegji Universum në nivelin institucional, Kampusi në Prishtinë dhe Dega në Ferizaj, për periudhën 3 vjeçare, 1 Tetor 2019 - 30 Shtator 2022.

II. Pjesa tjetër e vendimit të KShC-së Nr. Nr. 1362/19D, datë 29.07.2019, mbetet e pa ndryshuar.

III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji Universum ka parashtruar kërkesë për përmirësim të vendimit të KSHC-së Nr. 2537/21, datë 30.06.2021, në pikën një. Pas dëshmive të ofruara dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, është konstatuar se gjatë hartimit të vendimit, është lënë pa u përfshirë Dega në Ferizaj. AKA fillimisht ka verifikuar kërkesën në aplikacionin e dorëzuar nga Kolegji Universum, në të cilën figuron edhe kërkesa për akreditim të degës së Kolegjit Universum në Ferizaj. Për më tepër, AKA ka analizuar edhe materialet e dorëzuara, përfshirë raportin e vetëvlerësimit, raport i cili është trajtuar edhe nga ekspertët ndërkombëtar të kontraktuar nga AKA për vlerësim të institucionit. Prandaj KShC i AKA-së në mbledhjen e tij nr. 87 mbajtur më 27.07.2021, mbi bazën e dëshmive të ofruara, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Universum;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof.Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

